



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

Nr. 11 / 5, datë 30 /10 /2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “SOLAR ENERGY CELLS 300 MWP”
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË SOLAR ENERGY CELLS SHPK,
ME NUIS/NIPT: M26422204I**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon ndërtimin e një Parku Fotovoltaik në Bashkinë Vlorë, i cili parashikon të instalojë një kapacitet gjenerues të paneleve fotovoltaike prej 300 MWp në fazën finale të instalimit.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 175, 944,000 (*një qind e shtatëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë*) euro.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar ndodhen në ZK 1007, sipërfaqe 324 ha, shtet, Kategoria e VIII e Bonitetit.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Solar Energy Cells 300 MWP”, me subjekt investues shoqërinë Solar Energy Cells shpk, me NUIS/NIPT: M26422204I në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti prek në zonë të mbrojtur Peisazh i Mbrojtur ‘Pishë Poro-Nartë’, shpallur me VKM nr. 694, datë 26.10.2022 dhe Zonës me Përparësi Zhvillimin e Turizmit,

përkatësisht të Brezit Bregdetar, me sipërfaqe 1518, 95 km², miratuar me VKM nr. 1, datë 26.07.2018.

3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA